

1 Shkurt,2023

Të Nderuar Prindër dhe Nxënës të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Shkurti është muaji i Karrierës dhe Arsimit Teknik (CTE) -- një kohë për të festuar dhe rritur ndërgjegjësimin për rolin vendimtar që CTE luan në përgatitjen e shumë prej studentëve tanë për karrierë në fuqinë punëtore lokale, rajonale dhe kombëtare. Më shumë se 120 programet tona CTE në mbi 30 shkolla të mesme ofrojnë trajnim intensiv dhe mundësi të mësimit praktik për mijëra studentë që janë të interesuar të fitojnë aftësi profesionale për një sërë karrierash. Studentët e regjistruar në këto programe mësohen nga profesionistë të industrisë nga fusha e përqëndrimit që ata zgjedhin dhe fitojnë aftësitë teknike dhe akademike që u nevojiten për të pasur sukses pas shkollës së mesme.

Këtë muaj të CTE, ne po i festojmë studentët tanë duke shfaqur arritjet e tyre dhe zotërimin e aftësive të tyre teknike. Vizitoni “[CTE Month website](#)” për të mësuar më shumë rreth punës së programeve të ndryshme CTE dhe për të marrë pjesë në ngjarjet e muajit . Ju gjithashtu mund të merrni pjesë në festë duke thirrur studentët dhe edukatorët e CTE në mediat sociale, duke përdorur [#CTEMonth](#) dhe [#CTEphilly](#).

Sinqerisht,

Zyra e Komunikimeve